

REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA KOSOVA

NË EMËR TË POPULLIT

VENDIMËSHTË I PLOTFUQISHËM  
 OPIJKA JE PRAVNOSNAŽNA  
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
 FERIZAJ I UROŠEVAC

23.08.17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I  
 PËRGJITSHËM DIVIZIONI PENAL,

si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Adem Shabani si dhe me zyrtaren ligjore Lavdije Brahim, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga Ferizaj rruga ” [REDACTED] “, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par 5 lidhur me par 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1300-4/13 të datës 06.06.2017, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Veton Shabani, përfaqësuesja e të ndjerës nëna e saj [REDACTED], të pandehurit [REDACTED] dhe mbrojtësës me autorizim av. [REDACTED] pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 06.06.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### AKTGJYKIM

#### I akuzuari:

[REDACTED] nga Ferizaj rruga ” [REDACTED] “, i lindur me [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] gjinisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës ka të kryer shkollën e mesme, i martuar prind i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, mbrohet në liri,-

### ËSHTË FAJTOR

#### Sepse:

- më dt.24.08.2007 rreth orës 23:20 në rrugën “Bajram dhe Gürsel Sylejmani” në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës “Mercedes 200CDI” me ngjyrë të bardhë me targë të regjistrimit [REDACTED], në kundërshtim me dispozitat e nenit 54.1 të LSKRR nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që gjerë sa ka qenë duke lëvizur nga Ferizaji në drejtim të fshatit Gërlic afër fabrikës së pijeve “Fantra”, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve në rrugë, ku për shkak të shpejtësisë së madhe ka humbë kontrollin mbi automjetin ku ka dal jashtë rrugë në anën e djathtë të drejtimit të

vizjes, me ç' rast është rrokullisur dhe ka rrëshqitur rreth 150 m, nga pasoja e këtij aksidenti nga lëndimet e marrura në këtë aksident pas dërgimit në QKUK Prishtin ka ndrruar jetë tani e ndjera [REDAKTUAR] e lindur [REDAKTUAR], ndërsa lëndime trupore ka pësuar vetë i pandehuri dhe pasagjerët [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të cilat lëndime kualifikohen si lëndime të Lehta trupore me pasoja të përkohshme të shëndetit,-

- me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par 5 lidhur me par 1 të KPK-së.

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 3, 6, 11, 15, 34, 36, 38, 41, 42, 43, 54 dhe 64 të KPK-ës dhe nenit 365 të KPPK-ës, e,

## GJYKON

1. Të pandehurit [REDAKTUAR] i shqipton dënimi me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dates 25.08.2007 deri me datën 05.09.2007 dhe në arrest shtëpiak prej dt. 05.09.2007 deri me dt. 05.10.2007 dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimi me burgim të mos ekzekutohet nëse i pandehuri në kohën prej 2 /dy/ vite pasi ky aktgjykim të merrë formën e prerë nuk do të kryej veprën tjetër penale.

2. Konform nenit 54 par. 1 dhe 2 nënpar. 1 të KPK-së të pandehurit [REDAKTUAR] i shqipton dënim plotësues, **DËNIM NË GJOBË në shumë prej 2000 /dymijë / Euro** të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në katër këste mujore në afat prej katër muajsh, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Të dëmtuarit-përfaqësuesija ligjore e të ndjerës nëna e saj [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] që të dyja nga fsh. [REDAKTUAR] Komuna



erizaj [REDACTED] [REDACTED] që të dy nga Ferizaj dhe [REDACTED] nga fshati [REDACTED]  
Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore –juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligoheti i pandehuri që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 81,76 € si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### Arsyetim

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1300-4/13 të datës 06.06.2017, me të cilën ka ngarkuar të pandehurin [REDACTED] nga Ferizaj rruga ” [REDACTED] “, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par 5 lidhur me par 1 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.06.06.2017 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë Prokurori i Shtetit Veton Shabani, përfaqësuesja e të ndjerës nëna e saj [REDACTED], të pandehurit [REDACTED] dhe mbrojtësja me autorizim av. [REDACTED]

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestara i pandehuri është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drerjtat e të pandehurit janë rrespektuar, e ku prokurori i shtetit i ka lexuar atakuzën të pandehurit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I pandehuri [REDACTED] në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar mbetet pran deklaratave të më parme që ka dhënë në polici dhe para prokurorit të shtetit, edhe pse ka kaluar kohë e gjatë nuk i largohet rasti i ndodhjes së aksidentit nënës së të ndjerës i shpreh ngushllime i vijë rëndë për atë që i ka ndodhur, ku pas aksidentit kanë qenë tek familja e të ndjerës, për ngushllime, me familjen e të ndjerës kanë arritur pajtim, është i martuar baba i dy fëmijëve i ka

propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të merrë për bazë pranimin e fajsisë.

Mbrojtësja e të pandehurit av. [REDAKTUAR], në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se mbështet pranimin e fajsisë nga ana e të mbrojturit të saj, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajsisë dhe për veprën penale që akuzohet ti shqipton një denim të kushtëzuar ku do të arrihert qëllimi i denimit pasi me përfaqësuesen ligjore-nënë(së tani të ndjerës [REDAKTUAR] me [REDAKTUAR] kanë arritur pajtim për atë që i ka ndodhur, shprehje e thellë e keqëardhjes për atë që i ka ndodhur nënë së të ndjerës, është hera e parë që bie ndeshur me ligjin është mbajtës i familje baba i dy fëmive andaj i ka propozuar gjykatë që me rastin e shqiptimi të denimit ti merrë për bazë thekësimet e cekura më lartë.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza si në ekspertizen e komunikacionit të datës 18.09.2007 e ekspertit [REDAKTUAR] vërtetimin mbi vdekjen, e dt.12.nëntor 2007 e lëshuar nga dr. [REDAKTUAR] ekspertiza e ekspertit të mjekësisë i dt.17.07.2013 për konstatimin e lëndimeve e personave të lënduar si dhe fotografit që gjenden në shkresat e lëndës.

Përfaqësuesja ligjore e të ndjerës nëna e saj [REDAKTUAR], në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se menjëher pasë aksidentit me faltalite ku ka humbur vazën tani të ndjerën [REDAKTUAR] i kanë falur shkaktimin e aksidentin me fatalitet të pandehurit [REDAKTUAR] pasi vepra e kryer nuk është shkaktuar me dashje, nuk i bashkangjitet ndekjes penale, ka mbetur vetëm pran kërkesës pasuroro-juridike ku për të ndjeren nga kompania e sigurimeve ka marrë kompenzim.

Prokurori i shtetit Veton Shabani ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht dhe e ka mbështetur në faktet e çështjes që përmban akuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe pasi akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore pra pranimi i fajsisë është bërë konform ligjit.



Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par 5 lidhur me par 1 të KPK-së.

Gjykata me rastin e matjes së lartësisë së dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nen. 64 të KPPK-së si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, pendimin e shprehur për këtë veper penale, se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, me përfaqësuesen ligjore-nënë (së tani të ndjerës [REDAKTUAR]) me [REDAKTUAR] kanë arritur pajtim për atë që i ka ndodhur, shprehje e thellë e keqëardhjes, është mbajtës i familje baba i dy fëmijëve si rrethana rënduese mori rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, rrethanat e kryerjes së kësaj veper, dhe mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi dënim si në dispozitiv duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të pandehurit dhe me të arrihet qëllimi ndëshkimi në kuptim të preventivës speciale që i pandehuri të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3. të KPPK-së, të dëmtuarit përfaqësuesija ligjore e të ndjerës nëna e saj [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] që të dyja nga fsh [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] që të dy nga Ferizaj dhe [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së gjykata ka obliguar të akuzuarin që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 81,76 Euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.


Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P.nr.1360/2013 me datë 06.06.2017**

**Zyrtarja Ligjore**

Lavdiqe Brahimi



**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet  
ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimiit  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate

**Gjyqtari**

Adem Shabani

